

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE**  
**“EASY PONT” SH.P.K**  
**ME SELI NË TIRANË**

Sot, më datë 30/05/2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), unë i nënshkruari:

- **Z. Mentor HOXHA**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 08.11.1966, lindur në Roskovec Fier dhe banues në Via Grottemaria 57, Frascati, Rome, Itali, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me pasaportën me numër BI5836366 dhe me numër personal G61108052Q.

Vendosa:

Themelimin e shoqërisë tregtare “Easy Pont” Sh.P.K, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqërinë Tregtare Easy Pont SH.P.K, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri i shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin Easy Pont SH.P.K

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë kryerja e çdo aktiviteti tregtar të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrja në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar në baze të legjislacionit shqiptar, siç mund të ndryshohet here pas here dhe në veçanti, por pa u kufizuar në:

Aktivitet në fushën e ndërtimit të të gjitha llojeve, duke përfshirë këtu ndërtime për qëllime banimi, ndërtime me karakter social, kulturor, industrial, kanalizime, rehabilitime rrugësh, ndërtimin e tyre etj., por gjithnjë duke mos u kufizuar vetëm në to dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në këtë fushë; Prodhim materiale inerte. Prodhim elemente betoni e b/arme të zakonshëm-pararendur, gurë dekorative. Prodhim materiale me baze bitumi sintetike. Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore. Rikonstruksione. Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore. Ndërtim ambiente dhe sistemim gjelbërimi, parqe dhe lulishte. Eksport import. Punime karpenterie druri dhe



metalike, etj. Import eksport, prodhim, tregtim i artikujve te ndryshme te gjitha llojeve, me shumice dhe pakice si: Lule, fidanë dhe bime te ndryshme te tjera. Tregtim artikuj te ndryshëm industrial. Tregtim te konfeksioneve te ndryshme. Tregtim artikuj te ndryshëm ushqimore. Tregtim e pijeve alkoolike te bura, vere etj. Tregtim fruta-perime. Tregtim automjetesh te çdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjese këmbime për to. Hapje agjenci turistike. Hapje agjenci Imobilare. Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi dhe kurative. Agjenci transporti për udhëtare dhe pasagjeri, hoteleri, turizëm. Tregtim pajisjesh elektroshtepiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, higjeno sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizani, pajisje zytrash, etj. Transport mallrash te gjitha llojeve brenda dhe jashtë vendit. Tregtim prodhimesh kozmetike dhe estetike. Prodhime duraluminit dhe tregtimin e tyre. Tregtim prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi, dyer, dritare, parkete, shtëpi druri, etj. Tregtimin e karburanteve te ndryshme me pakice, si dhe vajrave lubrifikante, te gazit te lëngshëm për ngrohje si dhe për makinat me impiant gazi, pajisje ngrohëse gazi si dhe mbushjen e bombolave te gazit dhe tregtimin e tyre me pakice. Ndërtim dhe montim te impianteve për prodhimin e energjisë nga burime te ndryshme impiante elektrike për centralet dhe prodhim te transformatoreve, montim i linjave te tensionit te larte dhe te ulet, linjave te ndriçimit dhe aparaturave elektrike, mirëmbajtja e tyre. Gërmime dheu me punime eventuale muratore e beton arme. Prishje dhe punime ne toke te gërmuar. Magazinim frigoriferik për fruta – perime; Investimet ne fushën e medias, informacionit, reklamës dhe marketingut.

Gjithashtu, shoqëria mund te kryeje çdo aktivitet tjetër qe lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektivin e mësipërm, çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, si dhe çdo veprimtari me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme që mund te konsiderohet i nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të shoqërisë.

Për ushtrim të aktivitetit të shoqërisë me gjithë ndryshimet që mund të ketë shoqëria mund të hyjë më marrëveshje partneriteti dhe bashkëpunimi me palë të tretë qofshin ente publike apo private, të marrë pjesë në procedura të ndryshme konkurrimi në përputhje me legjislacionin ne fuqi. Të gjitha veprimtaritë do të zhvillohen në përputhje me ligjin që rregullon ushtrimin e asaj veprimtarie. Shoqëria do të marrë të gjitha licencat dhe miratimet që mund të jenë të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive të sipërpërmendura sipas kërkesave të ligjit të fushës.

#### **NENI 4**

##### **Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranës, në adresën: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Ndërtesa 6, Hyrja 11, Apartamenti 21, Njësia Bashkiake Nr 5, tiranë, Shqipëri.

#### **NENI 5**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi i ortakut themelues të kësaj Shoqërie, në para, në vlerën prej 1000 (një mijë) lek.



Kapitali themeltar të shoqërisë zotërohet nga **Z. Mentor Hoxha**, i cili në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100% të vlerës së kapitalit themeltar të përbërë nga një kuotë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortaku themelues në rast të miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe të firmosur nga ta.

#### **NENI 6**

##### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon pas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve/ortakut të vetëm.

#### **NENI 7**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/orataku i vetëm – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë do të jetë **Mentor Hoxha**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 08.11.1966, lindur në Roskovec Fier dhe banues në Via Grottemaria 57, Frascati, Rome, Itali, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me pasaportën me numër BI5836366 dhe me numër personal G61108052Q.


Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisllacionin në fuqi

#### **NENI 8**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 9**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdurojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.



**NENI 10**

**Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët/u themelues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 11**

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.


**NENI 12**

**Dispozitat përfundimtare**

Akti i Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe është në përputhje me vullnetin e lirë të themeluesit, i cili, nëpërmjet përfaqësuesve të tij e nënshkruan pa vërejtje.

**ORTAKU THEMELUES**

**MENTOR HOXHA**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Mentor Hoxha", is written over a diagonal line that crosses through the printed name above it.